



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 21.11.2012
Nr. 0204-1190

PËR: Rufki Suma, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
Menduh Vlashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NR, 7112, 7086, 7092, 7093, 7094,

Të pranuar më datën: 07/11/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit. Nr, 7112, 7086, 7092, 7093, 7094, të miratuar me datë 30.10.2012, nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi nr. 7112, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatit;
- Vendimi nr. 7086, për zgjerim të listës së projekteve kapitale;
- Vendimi nr. 7092, për raportin e buxhetit për periudhën Janar-Shtator;
- Vendimi nr. 7093, për RI-Alokimin e mjeteve të projekteve kapitale;
- Vendimi nr. 7094, për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e parcelës Nr.1046-0.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 21.11.2012
Nr. 0204-1190

Za: Rufki Suma, Gradonačelnik Opštine Hani i Elezit
Menduh Vlashi, Predsedavajući Skupštine Opštine Hani i Elezit

PREDMET: POTVRDA ZAKONITSOTI ODLUKE HANIT TË ELEZIT BR, 7112, 7086, 7092,
7093, 7094,

Primito dana: 07/11/2012

Poštovani,

Ministartvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim prema Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040 , Zakonom Br. 03/L-049 O Finansijama lokalne samouprave , dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke. br, 7112, 7086, 7092, 7093, 7094, usvojene dana 30.10.2012, od SO Hani i Elezit , POTVRDJUJE zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akti koji proizvode puni pravni efekat :

- Odluka br. 7112, o formiranju Komisije o izboru seoskih saveta;
- Odluka br. 7086, o proširenju liste kapitalnih projekata;
- Odluka br. 7092, za izveštaj o budžetu za period Januar-Septembar;
- Odluka br. 7093, za RI-Alokiranje sredstva za kapitalne projekte;
- Odluka br. 7094, za davanje saglasnosti za korišćenje parcele br.1046-0.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7112 2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimit Administrativ 2008/8 neni 6, Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane neni 4, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE TË FSHATIT

I

Miratohet propozim vendim me numër 02/Nr.7112/2012. për emërimin e komisioni për koordinimin dhe zgjedhjen e këshillave lokale

II

Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve nga të cilët, dy nga Kuvendi i Komunës (një i pozitës dhe një i opozitës), një nga ekzekutivi i komunës, një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

III

Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava
2. Nadire Mici
3. Fari Kalisi
4. Irfan Qajani dhe
5. përfaqësuesi i fshatit përkatës

IV

Nëpërmjet zyrës për informim të Komunës njofton qytetarët 15 ditë për tubimet e zgjedhjeve të këshillave lokale, me shpalljet publike. Njoftimi duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit.

V

Komisioni do të veprojë në harmoni me rregulloren e Kuvendit të Komunës për organizimin, bashkëpunim dhe lagjet urbane

VI

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit

VII

Më këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtorja për Administratë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.


Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Yllashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. FQ86 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6 shkronja (f), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM ✓
PËR ZGJËRIM TË LISTËS SË PROJEKTEVE KAPITALE

I

Miratohet Propozim vendimi me numër 06/Nr.7086/2012 për zgjerim të listës së projekteve kapitale.

II

Duke iu referuar nenint I miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe listës së projekteve kapitale për vitin 2012 i shtohet projekti kapital „Rregullimi i kanalizimit përgjat magjistrales nga pompa e benzinës Unio Comere deri te gropa septike”.

III

Ky projekt bartet nga lista e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2013 dhe zgjerimi i listës me projekte të reja bëhet për shkak të nevojës që është paraqitur gjatë kësaj periudhe.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendim njoftohet : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës- Han i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7092 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048 neni 45.4. Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM

PËR RAPORTIN E BUXHETIT PËR PERIUdhËN JANAR-SHTATOR

I

Miratohet raporti i shpenzimeve për periudhën janar – shtatorë për vitin 2012 .

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – shtatorë për vitin 2012 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa, në këtë raport përfshihen:

- Përmbledhja e implementimit të buxhetit janar - shtator 2012
- Raporti i të hyrave vetanake sipas programeve për periudhën janar-shtatorë 2012
- Progresi i shpenzimeve
- Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik
- Progresi i shpenzimeve aktuale deri më 30.09.2012
- Pagat dhe kompenzimet tjera
- Përmbledhja e shpenzimeve në mallra dhe shpenzime
- Shpenzimet komunale-komunalit
- Subvencionet dhe transferet
- Projektet kapitale për vitin 2012

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohet : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës- Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.7093/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Mbnaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 04/L-079 neni 12, 14, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM
PËR
RI-ALOKIMIN E MJETEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE

I

Miratohet propozim vendimi me numër 04.Nr.7093 për ri-alokimin e mjeteve nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale.

II

Duke iu referuar nenit I miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës. Nga kjo kategori ekonomike kemi rialokimin e mjeteve financiare për projektet kapitale nga granti qeveritar (fondi 10) në shumën prej 8.497.00 €, nga të hyrat vetanake (fondi 21) në shumë prej 48.549.00 € dhe një transfer brenda programit nga granti qeveritar (fondi 10) në shumën prej 502.25 €, pra në total rialokimi i mjeteve financiare është në shumë prej 57.548.25 €.

III

Ri-alokimi i projekteve kapitale nga granti qeveritar (fondi 10).

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet:
„Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-rrafshe-Meliq” kodë (86401) shuma prej 2.897.00 €.
„Rënövimi dhe adoptimi i zyrave në objektin e komunës (ish qendra)” kodë (86408) shuma prej 5.600.00 €, të alokohen në projektet :
„Rregullimi i kanalizimit nga rruga e të përndjekurve - Ura e Fezës” kodë (86404) në shumë prej 5.600.00 €. “Furnizim me kontinjër për Komunën e Hanit të Elezit” kodë (84270) në shumë prej 1.298.00 € dhe „Kanalizimi i ujërave të zeza në Ishatin Laç” kodë (86424) në shumë prej 1.599.00 €.

Rialokimi i projekteve kapitale nga të hyrat vetanake (fondi 21).

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet:
„Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-rrafshe-Meliq” kodë (86401) shuma prej 15.000.00 €.

„Rregullimi i kanalizimit nga rruga e të përndjekurve - Ura e Fezës” kodi (86404) në shumë prej 17.422.00 €;

„Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve – sh. T. Kështjella e Diturisë” kodi (86405) shuma prej 2.055.20 €.

„Fonde për trajnime” kodi (86421) shuma prej 2.000.00 €.

„Rregullimi i rrethojës së varrezave të dëshmorëve” kodi (86426) shuma prej 6.598.80 € dhe

„Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës së Gorancës” kodi (84269) shuma prej 5.473.00 € të rialokohen në projektet:

„Fonde për shpronësim” kodi (86420) në shumë prej 2.640.00€.

„Rregullimi i kanalizimit përgjatë magjistrales (nga pompa e benzinës Unio Comerc deri te gropa septike)” kodi (i ri) në shumë prej 35.000.00€.

„Mjete të lira për Bashkëinvestime” kodi 86429 në shumë prej 6.409.00€ dhe

„Shtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit” me kod (86402) në shumë prej 4.500.00€

Transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale nga programi Arsim dhe Shkencë (920) nën-programi (95220) në programin Arsimi dhe shkencë (920) nën-programi (94020).

Nga programi Arsim dhe Shkencë (920) nën-programi (95220) nga projekti “Rregullimi i kulmit ndriçues të sh.m. Dardania” kodi (86431) shuma prej 502.25€ të transferohet në programin Arsimi dhe shkencë (920) nën-programi (94020) në projektin “ Rregullimi i infrastrukturës shkollore” kodi (86430) në shumë prej 502.25€.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendim njoftohet : Kryetari i Komunës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit Komunal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7094/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - nr. 28/2008). Statutin e Komunës neni 79, shkresën përcjellëse me numër 11/Nr.7094/2012 të datës 09.10.2012 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit me numër 11-Nr.6948/2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SHFRYTËZIMIN E PARCELËS Nr.1046-0

I

I jepet në parim pëlqimi z.Nexhmedin Brava për shfrytëzimin e një pjese të parcelës Nr.1046-0 mal i klasit të pestë në vendin e quajtur „Osoj” e evidentuar në certifikatën e pronësisë.Nr.100 pronë shoqërore e ekonomisë pyjore zona kadastrale Pustenik me një sipërfaqe prej $S=0.05.77$ ha për ndërtimin e një objekti hoteleri-restorant.

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor. kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

